



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 122/2018

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 108/2014 “PËR POLICINË
E SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

II. Shqyrtimi në Komisionin përgjegjës për Sigurinë Kombëtare të bëhet në datat 17-18 dhjetor 2018.

III. Amendamentet të dorëzohen në komisionin përgjegjës brenda datës 17 dhjetor 2018.

IV. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 20 dhjetor 2018.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 13.12.2018